

QKSS dhe Drejtoria e Arsimit në Prishtinë nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për sigurinë në shkolla



FAQE 6

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RINUMËRIM I PLOTË I VOTAVE NË KOSOVË

FAQE 4-5



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka marrë vendim që në 28 komuna të shkohet me rinumërim të plotë të të gjitha votave nga zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025. Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka deklaruar se procesi i rinumërimit të votave ka nxjerrë në pah pasaktësi të theksuara në numërimin e votave të kandidatëve, ndërsa votat e subjekteve politike rezultojnë kryesisht të sakta. Po ashtu, KQZ-ja ka shkarkuar përfaqësuesit politikë në Komisionin Komunal Zgjedhor në Prizren ku, sipas Radoniqit, janë vërejtur dallimet më të mëdha në votat për kandidatët për deputetë. Rinumërimi i plotë i votave pritet ta shtyjë konstituimin e përbërjes së re të Kuvendit dhe formimin e ekzekutivit të ri

“DUAN APO S’DUAN”: KURTI, FITUES NË KOSOVË DHE PARTNER I VËSHTIRË JASHTË SAJ

F. 3



ËNDRRA AMERIKANE NË PRITJE: MIJËRA SHOQIPTARË TË PREKUR NGA PEZULLIMI I VIZAVE TË EMIGRIMIT

F. 7



AKTUALE



TË PAKTËN 39 TË VDEKUR PAS PËRPLASJES SË DY TRENAVE NË SPANJË

F. 2

ARRESTOHEN KATËR TË DYSHUAR PËR KEQPËRDORIM TË POZITËS ZYRTARE DHE MARRJE RYSHFETI

F. 6

TENSIONET SHBA - IRAN MBETEN TË LARTA, TEHERANI KËRCËNON PËR SHTYPJE TË MËTEJME

F. 2



KOSTT MERR PRONËSINË E NGASTRËS NË SOJEVË TË FERIZAJT PËR VENDOSJEN E BATERIVE 90 MWH PËR RUAJTJEN E ENERGJISË

F. 8

DAVOS DHE FORUMI EKONOMIK BOTËROR: PUSHTETI, KAPITALI DHE ARKITEKTURA EKONOMIKE E BOTËS

F. 8

Shkruan: Nazmi JUSUFI

SPORT



LUFTA NË KOSOVË, RILINDJA ME MALLORCËN DHE ËNDRRA E BOTËRORIT: MURIQI “PUSHTON” LA LIGËN

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mod: +377 44 501 289
E-mail: renova@mtl.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TË PAKTËN 39 TË VDEKUR PAS PËRPLASJES SË DY TRENAVE NË SPANJË

MADRID, 19 JANAR - Numri i viktimave nga përplasja e dy trenave në Spanjë është rritur në 39 dhe 152 persona të tjerë janë lënduar, raporto i transmetuesi shtetëror spanjoll RTVE, duke u thirrur në burime policore. Paraprakisht, autoritetet spanjolle kishin konfirmuar vdekjen e 21 personave, pasi të dielën një tren i shpejtë doli nga shinat dhe u përplas me një tren tjetër që po vinte në drejtim të kundërt në jug të Spanjës. Aksidenti ndodhi në afërsi të Adamuzit, provincë e Kordobës, që gjendet rreth 360 kilometra në jug të kryeqytetit, Madrid. Mëngjesin e së hënës kreu i qeverisë rajonale të Andaluzisë, Juanma Moreno, paralajmëroi për mundësinë e rritjes së numrit të viktimave, pasi njoftoi se disa nga të shtruarit në spital ishin në gjendje të rëndë. “Forca e aksidentit ka qenë shumë e madhe... ka gjasa të gjejmë [edhe] trupa të tjerë”, tha Moreno, duke shtuar se do të nevojiten mjete të rënda për t'i larguar pjesët metalike të shkatërruara të trenave, në mënyrë që të tentohet të lokalizohen viktimat e tjera të mundshme. Video nga vendi i ngjarjes, të shpërndara në rrjetet sociale, shfaqën ekipet e shpëtimit duke nxjerrë pasagjerët nga vagonët.

Disa pasagjerë dolën nga dritaret e thyera, ndërsa të tjerë u larguan me barela. Gazeta “El Pais” raportoi se mes viktimave ishte edhe drejtuesi 27-vjeçar i trenit që udhëtonte nga Madridi drejt Huelvës, përkatësisht shoferi i trenit që u godit. Në dy trenat që u përplasën ndodheshin rreth 400 pasagjerë, shumica prej tyre spanjollë që po ktheheshin drejt dhe nga Madridi pas fundjavës. Nuk është e qartë se sa turistë mund të kenë qenë në bordin e dy trenave, pasi që janari nuk është sezon pushimesh në Spanjë. Treni i dytë, që ishte nisur për në Huelva dhe operohej nga Renfe - kompani e financuar nga shteti - po udhëtonte me një shpejtësi rreth 200 kilometra në orë në momentin e përplasjes, raporto i “El Pais”. Nuk është e qartë se me çfarë shpejtësie po udhëtonte treni i parë që doli nga shinat. Shkaku i përplasjes ende nuk dihet, tha ministri spanjoll i Transportit, Oscar Puente, në një konferencë për medie në Madrid, duke shtuar se “është shumë e çuditshme” që dalja nga shinat ndodhi në një segment të drejtë të hekurudhës. Ky segment ishte rinovuar në muajin maj, shtoi ai. “Sonte është një natë e dhimbjes së



madhe për vendin tonë”, shkroi në X kryeministri spanjoll Pedro Sanchez. Ndërkaq, një zëdhënës i pallatit mbretëror tha se mbreti dhe mbretëresha e Spanjës po përcjellin me shqetësim zhvillimet. Aksidenti ndodhi në orën 19:45, sipas kohës lokale, rreth 10 minuta pasi treni i kompanisë Iryo u nis nga Kordoba drejt Madridit, thanë autoritetet. “Treni Iryo 6189 Malaga [drejt Madridit] ka dalë nga shinat në Adamuz, duke u përplasur në linjën hekurudhore ngjitur. Edhe

treni [nga Madridi] drejt Huelvës, i cili po udhëtonte në këtë linjë ngjitur, ka dalë nga shinat”, njoftoi përmes rrjeteve sociale, “Adif”, kompania që menaxhon rrjetin hekurudhor në Spanjë. Puente tha se shumica e viktimave ndodhen në dy vagonët e parë të trenit të dytë, “Renfe Alvia”, që doli nga shinat pas përplasjes. Në vagonin e parë gjendeshin 37 persona, ndërsa në të dytin 16, tha ai. Treni i kompanisë “Iryo” kishte më shumë se 300 pasagjerë, ndërkaq i “Renfes” rreth 100.

Iryo është një operator privat i trenave dhe shumica e aksioneve në këtë kompani janë nga grupi hekurudhor në pronësi shtetërore italiane, “Ferrovie dello Stato”. Kjo kompani tha përmes rrjeteve sociale se i vjen keq për atë që ka ndodhur dhe se ka aktivizuar të gjithë protokollet e emergjencës për të punuar ngushtë me autoritetet. Ndërkaq, “Renfe” tha se aksidenti ndodhi pasi treni “Iryo” doli nga shinat, duke shtuar se shërbimet e emergjencave ende po nxjerrin pasagjerë.

TENSIONET SHBA - IRAN MBETEN TË LARTA, TEHERANI KËRCËNON PËR SHTYPJE TË MËTEJME

TEHERANI, 19 JANAR - Tensionet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Iranit mbeten të larta teksa sundimtarët e linjës së ashpër në Teheran kanë përsëritur retorikën armiqësore dhe kërcënimet se do të japin “ndëshkime të ashpra” - përfshirë edhe mundësinë e ekzekutimeve - ndaj protestuesve antiqeveritarë. Presidenti iranian Masud Pezeshkian - që më herët konsiderohej nga shumë si relativisht i moderuar në mesin e udhëheqësve të Iranit - më 18 janar paralajmëroi se një sulm ndaj liderit suprem të shtetit, ajatollah Ali Khameneit, do të shkaktonte “një luftë në shkallë të plotë”. “Një sulm ndaj udhëheqësit të madh të shtetit tonë është i barasvlershëm me një luftë në shkallë të gjerë me kombin iranian”, tha Pezeshkian përmes një postimi në rrjetet sociale. Në një fjalim më 17 janar, Khamenei e vlerësoi rolin e Pezeshkianit në shtypjen e protestave të fundit, teksa pranoi se gjatë protestave janë vrarë “disa mijëra” persona. Presidenti amerikan Donald



Trump është kryesori në mesin e udhëheqësve perëndimorë që ka kritikuar. Presidenti Trump tha për “Politico” - deklarata që u publikuan më 17 janar - se Khamenei ishte fajtor për “shkatërrimin e plotë të vendit dhe përdorimin e dhunës në nivele të papara më parë”, duke shtuar se kishte ardhur koha për

të kërkuar një “udhëheqje të re” në Iran. Sfidë e fundit nga qeveria teokratike shpërtheu më 28 dhjetor të vitit 2025, me protestuesit që dolën në rrugë për shkak të krizës ekonomike, para se demonstratat të përhapeshin në shkallë më të gjerë. Trumpi fillimisht kishte

paralajmëruar se ShBA-ja “ishte gati” për të vepruar nëse forcat iraniane të sigurisë do t'i vrisnin protestuesit. Më pas ai kërcënoi se do të ndërmernte “veprime shumë të forta” nëse Irani do të ekzekutonte protestues pas raportimeve për planifikim të ekzekutimeve. Më vonë, Trumpi njoftoi se po pezullonte planet e sulmit pasi

Irani kishte anuluar 800 ekzekutime, megjithëse Teherani nuk e ka konfirmuar këtë shifër dhe nuk ka treguar nëse planet për varjen e protestuesve janë anuluar krejtësisht. Grupi Iran Human Rights, me seli në Norvegji, ka verifikuar vrasjen e të paktën 3 428 nga forcat e sigurisë, ndërkaq HRANA, me seli në ShBA, ka verifikuar vdekjen e të paktën 3 308 protestuesve dhe më shumë se 24 000 arrestimeve. Kjo organizatë ka shtuar se 4 382 raste të tjera janë nën shqyrtim. Grupe të tjera të aktivistëve kanë dhënë shifra shumë më të larta të viktimave, por për shkak të bllokimit të internetit është bërë i vështirë verifikimi i informacioneve. Ndërkaq, zëdhënësi i gjyqësorit iranian, Asghar Jahangir, ka sugjeruar se ekzekutimet mund të kryhen ende. “Një sërë veprash janë identifikuar si mohareb, që është një nga ndëshkimet më të rënda islame”, tha ai në një konferencë për media më 18 janar. Mohareb, ose lufta kundër Zotit, dënohet me vdekje, sipas ligjeve iraniane.

RINUMËRIM I PLOTË I VOTAVE NË KOSOVË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka marrë vendim që në 28 komuna të shkohet me rinumërim të plotë të të gjitha votave nga zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025. Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, ka deklaruar se procesi i rinumërimit të votave ka nxjerrë në pah pasaktësi të theksuara në numërimin e votave të kandidatëve, ndërsa votat e subjekteve politike rezultojnë kryesisht të sakta. Po ashtu, KQZ-ja ka shkarkuar përfaqësuesit politikë në Komisionin Komunal Zgjedhor në Prizren ku, sipas Radoniqit, janë vërejtur dallimet më të mëdha në votat për kandidatët për deputetë. Rinumërimi i plotë i votave pritet ta shtyjë konstituimin e përbërjes së re të Kuvendit dhe formimin e ekzekutivit të ri

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që të ketë rinumërim të plotë të të gjitha votave në vendvotimet në 28 komuna. Po ashtu, është vendosur që të shkarkohen përfaqësuesit politikë në Komisionin Komunal Zgjedhor në Prizren, ku sipas kreut të KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, janë vërejtur dallimet më të mëdha në votat për kandidatët për deputetë. Paraprakisht, në këto 28 komuna KQZ-ja kishte vendosur të rinumëroheshin vetëm 10 për qind e vendvotimeve, ndërsa në 10 komuna të tjera vendosi për rinumërim të plotë.

Vendimi i 19 janarit vjen pasi gjatë rinumërimit të pjesshëm u vërejtën dallime të mëdha në votat për kandidatët për deputetë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit të vitit 2025.

Pas zbulimit të këtyre devijimeve, partitë dhe organizatat e shoqërisë civile kërkuar rinumërim të plotë të votave. Gjatë mbledhjes, kreu i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se në mbledhjen e mbajtur nga Këshilli për Operacione i KQZ-së u analizua raporti i rinumërimit të pjesshëm. Sipas tij, dallimi në votat për partitë politike është minimal dhe "i papërfillshëm", ndërsa ai te kandidatët ka "shkallë të lartë të pasaktësisë". "Prizreni është rasti më ekstrem", ka thënë Radoniqi, duke shtuar se 20 343 vota u janë zbritur kandidatëve për deputetë gjatë rinumërimit. Ai tha se në komuna të tjera nuk vërehen dallime të mëdha në votat për kandidatë. Anëtarët e partive politike në KQZ përkrahën të dyja rekomandimet, duke kërkuar që të ketë përgjegjësi ligjore për devijimin e rezultatit.

Në mbledhje anëtarë nga radhët e komunitetit boshnjak, Almir Sahiti, kërkoj që në rinumërim të përfshihen edhe votat e diasporës.

Kryetari i KQZ-së tha se për këtë propozim do të vendoset pas mbledhjes, ndërsa disa anëtarë të tjerë thanë se këto vota veçse janë numëruar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, aty ku gjetën edhe mospërputhjet në votat për kandidatë për deputetë. Më 13 janar KQZ-ja nisi rinumërimin e plotë të votave në 10 komuna (Dragash, Kaçanik, Leposaviq, Prizren, Skenderaj, Shtime, Ferizaj, Vushtrri,



Kosovo Election Commission (Public domain)

Mamushë dhe Ranillugu), pasi në verifikimin e 2 për qind të vendvotimeve gjeti mospërputhje të votave të kandidatëve.

Tani numërimi i plotë do të bëhet edhe në 28 komuna të tjera, ku paraprakisht u vendos të numëroheshin vetëm 10 për qind e vendvotimeve: Deçan, Gjakovë, Glllogoc, Gjilan, Istog, Klinë, Fushë-Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Zubin-Potok, Zveçan, Malishevë, Junik, Hani i Elezit, Graçanicë, Partesh, Kllloket dhe Mitrovicë e Veriut.

Pas vendimit për rinumërimin e pjesshëm ishte paraparë që 914 vendvotimet të numëroheshin për rreth dy javë. Deri më tani, 586 vendvotime janë rinumëruar.

Pas konstatimit se ka dallim në vota për kandidatët për deputetë, Prokurori i Shtetit u vu në lëvizje më 19 janar. Koordinatorja nacionale për zgjedhje, prokurorja Laura Pula, u ka kërkuar kryeprokurorëve në të gjitha prokuroritë themelore, që në të gjitha komunat ku ka përfunduar procesi i rinumërimit "të fillojnë grumbullimin e informatave të nevojshme dhe të sigurojnë prova relevante, që vërtetojnë kryerjen e ndonjë veprë penale që ndërlidhet me procesin zgjedhor".

Një ditë më parë Prokuroria Themelore e Prizrenit e autorizoi policinë që t'i identifikojë fajtorët për këtë mospërputhje në vota. Përfaqësuesit e partive politike dhe organizata që monitorojnë

procesin zgjedhor kërkuar rinumërim të plotë të votave.

Më 9 janar KQZ-ja njoftoi se kishte përfunduar procesi i numërimit të të gjitha votave. Votat e rregullta u numëruan nëpër qendrat komunale të numërimit, ndërsa votat e tjera, përfshirë ato nga diaspora në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Gjatë procesit të numërimit në qendrat komunale të numërimit çdo fletëvotim kalon përmes disa kontrolleve: lexohet me zë të lartë nga një numërues, shfaqet në ekran përmes kamerës dhe regjistrohet në sistem elektronik nga një zyrtar tjetër, ndërsa një person i tretë e verifikon fletën. Megjithatë, manipulimi thuhet se bëhet në fazën e leximit të votave për kandidatë. Kur një fletëvotim i takon një partie, ai përmban edhe vota për disa kandidatë. Numëruesi mund të ndryshojë verbalisht numrin e kandidatit të votuar, duke e zëvendësuar me numrin e një kandidati tjetër. Kështu, sistemi regjistron votë për kandidatin e gabuar, edhe pse fletëvotimi real tregon diçka tjetër. Numri i votave për parti nuk ndryshon, vetëm ndryshon numri i votave për kandidatë brenda së njëjtës parti.

Manipulimi i votave në Kosovë është vepër penale. Megjithatë, së voni organizata joqeveritare "Çohu" publikoi një hulumtim që tregoi se mbi 90 për qind e rasteve për manipulime zgjedhore përfundojnë me dënime me kusht ose gjoba. Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje është fituesja

e zgjedhjeve me mbi 51 për qind të votave të fituara. Ajo pritet të ketë 57 ulëse në legjislaturën e dhjetë. Rinumërimi i plotë i votave pritet ta shtyjë konstituimin e përbërjes së re të Kuvendit dhe formimin e ekzekutivit të ri.

DnV-ja: Hetimet t'i përfshijnë edhe kandidatët

Një javë pas publikimit të gjetjeve të para dhe pas konfirmimit të devijimeve masive në numërimin e votave preferenciale për kandidatë në disa komuna, shmangia nga vendimi për një rinumërim të plotë në nivel vendi po e thellon krizën e besimit në integritetin e procesit zgjedhor. "Devijime të konsiderueshme janë evidentuar jo vetëm në komunat ku është bërë rinumërim i plotë, por edhe në një pjesë të komunave, vendvotimet e të cilave janë të përfshira në mostrën prej 10 %.

Kjo tregon se fenomeni nuk është i izoluar dhe se përmasa reale e shtrembërimit të votës së kandidatëve nuk mund të vlerësohet me siguri përmes rinumërimeve selektive", ka thënë DnV-ja në reagimin për medie. Në këtë kontekst, DnV-ja ka pohuar se rinumërimi i pjesshëm, sado i zgjeruar, nuk garanton besueshmërinë e rezultatit përfundimtar. "Vetëm një rinumërim i plotë i votave preferenciale në të gjitha komunat mund të sigurojë se vullneti i

votuesve është reflektuar saktë dhe se nuk ka vendvotime të mbetura jashtë verifikimit, të cilat mund të ndikojnë në renditjen dhe mandatin e kandidatëve. Kjo mbetet mënyra e vetme për rikthimin e besimit publik dhe për mbylljen përfundimtare të çdo dileme mbi legjitimitetin e rezultateve", ka vlerësuar DnV-ja. Paralelisht, DnV vlerëson se gjetjet e deritanishme krijojnë bazë të mjaftueshme që organet e drejtësisë ta trajtojnë këtë çështje me prioritet dhe me një qasje të mundshëm të veprimeve të koordinuara që mund të kenë cenuar integritetin e numërimit. Në mënyrë të veçantë, DnV vlerëson se hetimi duhet të shtrihet përtej nivelit teknik të procesit të numërimit. "Modelet e përsëritura të devijimeve në favor të kandidatëve të caktuar brenda dhe nëpër komuna të caktuara krijojnë bazë të arsyeshme për dyshimin se këto nuk janë produkte të gabimeve njerëzore apo të rastësisë, por të veprimeve të qëllimshme të komisionarëve. Për rrjedhojë, edhe kandidatët që rezultojnë përfitues nga këto mospërputhje dhe manipulime duhet të jenë pjesë e hetimeve, në mënyrë që të sqarohet nëse ka pasur nxitje, koordinim apo përfshirje direkte apo indirekte në manipulimin e votës", ka theksuar DnV-ja.



‘DUAN APO S’DUAN’: KURTI, FITUES NË KOSOVË DHE PARTNER I VËSHTIRË JASHTË SAJ

Fitorja bindëse e Albin Kurtit në Kosovë erdhi pas një periudhe përplasjesh serioze me ShBA-në dhe BE-në, që çuan deri te masa ndëshkuese dhe ftohje të bashkëpunimit. Partnerët perëndimorë shprehin gatishmëri për të punuar me qeverinë e ardhshme, por e lidhin këtë me përparim konkret në dialogun Kosovë - Serbi. Analistët vlerësojnë se mbështetja e fortë elektorale e forcon pozitën e Kurtit ndërkombëtarisht, njëkohësisht e bën më të vështirë arritjen e kompromiseve të shpejta

PRISHTINË, 19 JANAR - Albin Kurti fitoi bindshëm brenda Kosovës, por një test tjetër i vështirë mund të jetë edhe jashtë saj. Mandati që i dha populli në zgjedhje, me mbi 51 për qind të votave, vjen pas një periudhe marrëdhëniesh të tensionuara me aleatët perëndimorë, deri në atë pikë sa vetë partneritetet strategjike nisën të lëkundeshin. Tensionet u ushqyen nga një sërë veprimesh të qeverisë së kaluar të Kurtit - nga vendosja e kryetarëve shqiptarë në komunat me shumicë serbe në

veri, deri te mbyllja e shumicës së institucioneve serbe të cilat u cilësuan nga bashkësia ndërkombëtare të njëanshme, të pakoordinuara dhe problematike për komunitetin serb. Në kulmin e krizës, më 2023, atëkohë sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, i dënoi ashpër veprimet e tilla, për të cilat tha se ishin “kundër këshillave të ShBA-së dhe partnerëve evropianë të Kosovës”. Ai, po ashtu, paralajmëroi pasojat për

marrëdhëniet dypalëshe në mes të Kosovës dhe ShBA-së. Dhe, pasojat nuk vonuan: vetëm pak ditë më vonë Kosova u përjashtua nga stërvitjet ushtarake “Defender Europe 2023”, nikoqire e të cilave ishte vetë. Për Kurtin, tani në retrospektivë, “ia ka vlejtur barra qiranë”, pasi strukturat paralele të Serbisë janë eliminuar dhe shteti ka shtrirë rendin dhe ligjin. “Ne jemi miq përkundër kritikave. Ne nuk jemi miq të vërtetë nëse nuk arrijmë ta normalizojmë

kritikën për njëri-tjetrin”, tha Kurti për Televizionin Kanal 10 në Prishtinë në dhjetorin e kaluar. Por, në kontrast me deklaratat e tij për “normalizimin e kritikave mes miqve”, ShBA-ja vitin e kaluar i shoqëroi mospajtimet e saj edhe me pezullimin e Dialogut Strategjik me Kosovën - një mekanizëm i krijuar për thellimin e marrëdhënieve dypalëshe. Qëndrimin e tillë të Uashingtonit e forcoi në dhjetor edhe një takim i Komitetit për Politikë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, në të cilin Kurti u përshkrua si pengesë në avancimin e proceseve. Në Kosovë, megjithatë, perceptimi duket krejt ndryshe. Me mbi 51 për qind të votave në zgjedhjet e 28 dhjetorit, Lëvizja Vetëvendosje synon ta rikthejë Kurtin në krye të qeverisë dhe t’i

krijojë sa më shpejt institucionet e reja - një hap që duket se do të testojë edhe durimin, edhe qasjen e partnerëve ndërkombëtarë. Kur u pyet nga Radio Evropa e Lirë për mënyrën se si Shtetet e Bashkuara planifikojnë të bashkëpunojnë me qeverinë e ardhshme, Ambasada Amerikane në Prishtinë theksoi gatishmërinë për forcimin e marrëdhënieve por, paralelisht, specifikoi se kjo do të kërkojë edhe përmbushjen e disa kushteve. “Shpresojmë të forcojmë partneritetin tonë me Qeverinë e ardhshme të Kosovës, përfshirë edhe rifillimin e Dialogut Strategjik. Arritja e kësaj, megjithatë, do të kërkojë veprime nga Qeveria e Kosovës që çojnë përpara agjendën tonë të përbashkët për paqe rajonale, stabilitet dhe prosperitet të ndërsjellë

ekonomik”, tha një zëdhënës i Ambasadës amerikane. Në fund të vitit të kaluar ShBA-ja miratoi Aktin për Autorizimin e Mbrojtjes Kombëtare, duke theksuar, mes të tjerash, nevojën që Kosova dhe Serbia t’i normalizojnë marrëdhëniet. Që nga viti 2011 dy vendet kanë zhvilluar negociata dhe kanë arritur disa marrëveshje, por shumica e tyre nuk janë zbatuar. Që nga shtatori i vitit 2023 nuk ka pasur as ndonjë takim të nivelit të lartë, sepse Serbia nuk e ka dorëzuar të dyshuarin për sulmin në Banjskë, Millan Radoiqiq - hap ky që Kurti e ka kërkuar pa ndërprerje nga Beogradi dhe nga partnerët ndërkombëtarë. Këtë javë Kosovën e vizitoi i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Peter Sorensen, i cili e përshëndeti procesin zgjedhor. Vizita u zhvillua në kohën kur Kosova pritet të dalë nga masat ndëshkuese të BE-së, të vendosura për më shumë se dy vjet, për shkak të veprimeve të konsideruara të njëanshme. Nga Prishtina, Sorenseni rikujtoi se vazhdimi i dialogut në nivel të lartë me Serbinë mbetet kyç. “Ne vazhdojmë të punojmë për çështjet e dialogut, me shpresën që viti 2026 të sjellë atë që 2025-a nuk e solli. Pikërisht për këtë arsye e nisa vitin me një vizitë këtu dhe më pas në Beograd gjatë kësaj jave”, u tha Sorenseni medieve. Pas takimit me Sorensenin, Kurti deklaroi se Kosova është e gatshme për dialog konstruktiv dhe normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, por

përsëriti kushtet e tij: dorëzimin e Millan Radoiqiqit dhe tërheqjen e letrës së vitit 2023, me të cilën Serbia shprehu rezerva ndaj Marrëveshjes për normalizim me Kosovën dhe aneksit të zbatimit të saj. Duke iu përgjigjur Radios Evropa e Lirë për mënyrën se si planifikojnë të angazhohen me Qeverinë e re të Kosovës, edhe Zyra e BE-së në Kosovë dhe Ambasada e Gjermanisë theksuan rëndësinë e vazhimit të dialogut me Serbinë dhe shprehën mbështetje për të. Ndërkohë, vendet e tjera të Quint-it - Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia - nuk iu përgjigjën pyetjes. Mandati i fortë, vlerësojnë disa analistë, ia forcon Kurtit pozicionin edhe përballë BE-së dhe ShBA-së. Florian Bieber, drejtor i Qendrës për Studime të Evropës Juglindore, thotë se kjo i jep atij hapësirë politike për ta vazhduar kursin aktual - edhe kur ai nënkupton vendime jopopullore dhe qëndrime më të ashpra në dialogun me Serbinë. “Mesazhi për aktorët ndërkombëtarë është mjaft i qartë: ata duhet të bashkëpunojnë me Kurtin. Duan apo s’duan, ai është aktori politik dominues në Kosovë. Edhe më herët partia e tij ka qenë larg më e popullarizuar. Dhe, aktualisht, nuk ka asnjë alternativë të fortë politike”, thotë Bieber për programin “Expose” të Radios Evropa e Lirë. Lisa Homel, drejtoreshë e Qendrës për Evropë në Këshillin Atlantik, e përmbledh ngjashëm situatën: “Kurti ka një

mbështetje të jashtëzakonshme dhe të qartë pas vetes” dhe kjo “do ta inkurajojë atë në marrëdhëniet me Brukselin dhe Uashingtonin”. Sipas saj, ai do të jetë i gatshëm të angazhohet në dialog, por më pak i predispozuar për kompromis, sidomos në marrëdhëniet me Serbinë. “Kurti e ka marrë mesazhin nga qytetarët e Kosovës se qëndrimi i tij ndaj Serbisë është popullor. Kjo i jep atij një pozicion të qartë dhe të paluhatshëm. Nuk pres të ketë përparim të madh të menjëhershëm, por mund të shohim më shumë lëvizje, deklarata dhe ngjarje mediatike pas vitit 2025, pasi, deri më tani, gjithçka ka qenë e bllokuar nga ngërçi politik në Kosovë”, thotë Homel për “Exposenë”. Pothuajse gjatë gjithë vitit të kaluar Kosova ishte me qeveri në detyrë, pasi partia e Kurtit s’arriti të formonte qeverinë e re pas zgjedhjeve të 9 shkurtit - çfarë edhe çoi në proces të parakohshëm zgjedhor. Në këtë kontekst, Bieber thotë se mandati i fortë i Kurtit nuk është thjesht një pohim i gjithçkaje që ka bërë qeveria e tij, por edhe ndëshkim publik i dështimit të opozitës për të mbështetur një qeveri të re. Bieber thotë se reagim logjik i BE-së do të ishte që të përshtatej dhe të angazhohej me Kosovën e jo ta izolonte atë. Sipas tij, BE-ja duhet ta rimendojë dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, duke u angazhuar me Kurtin si partner. “Sigurisht, tani ekziston një partner që do të mund të bënte kompromise nëse ka vullnet për ta bërë këtë, në

mënyrë që dialogu të çohet përpara në një fazë ku, të paktën pala kosovare, të mos shihet më si penguese. Kjo do ta zhvendoste qartazi përgjegjësinë te pala serbe dhe do ta orientonte dialogun drejt një procesi më konstruktiv”, thotë Bieber. Gjatë mandatit të kaluar Kurti akuzoi shpesh zyrtarët evropianë për “pozicionim kundër Kosovës” dhe për koordinim me palën serbe kundër Kosovës. Bieber argumenton se autoriteti i Serbisë në Kosovë “është dobësuar” nga qeveria paraprake e Kurtit dhe më tej nga sulmi në Banjskë, ku dyshohet se ishin të përfshirë njerëz nga Lista Serbe. Kjo e lë Serbinë në një “pozicion më të dobët negociues sesa ishte më parë”, sipas tij. Homel, nga Këshilli Atlantik, nuk pret rritje të presionit ndërkombëtar ndaj Serbisë, duke vënë në dukje se, përballë krizave të shumta globale, Ballkani Perëndimor vështirë se do të jetë prioritet i lartë - veçanërisht për Uashingtonin. Sipas saj, rifillimi i Dialogut Strategjik ShBA - Kosovë, nëse ndodh, do të jetë sinjali më i qartë i mënyrës se si Uashingtoni synon të angazhohet me Prishtinën. Nga BE-ja pritjet i ka gjithashtu të kufizuara dhe jo vetëm për dialogun. “Sapo ka nisur Presidenca e Këshillit të Bashkimit Evropian, e udhëhequr nga Qiproja, një nga pesë vendet që nuk e njohin Kosovën. Prandaj, është e vështirë të shihet ndonjë

përparim në procesin e zgjerimit gjatë Presidencës së Qipros. Por, ndoshta kur Irlanda ta marrë Presidencën pas disa muajsh, mund të shohim lëvizje më të dukshme”, thotë Homel. Nisur nga kjo, Homel sheh një status quo. Sipas saj - larg ideale, por realiteti më i mundshëm, dhe përgjegjësia nuk bie vetëm mbi bashkësinë ndërkombëtare. “Një nga aspektet më sfiduese të normalizimit të marrëdhënieve është se duhet të vijë nga vetë rajoni. Bashkësia ndërkombëtare mund t’i shprehë prioritetet dhe ambiciet e saj por, në fund, iniciativa dhe zgjidhjet duhet të vijnë nga vetë Kosova dhe Serbia”, thotë Homel. Dhe këtu nuk jemi ende... Serbia është e përfshirë nga protestat e brendshme antiqeveritare, ndërsa Kurti i porositi përfaqësuesit e shteteve të BE-së në Kosovë se mandati i ardhshëm do të jetë “mandat i projekteve të mëdha infrastrukturore, të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik”. Por, në kohën kur paparashikueshmëria është bërë normë, asnjë datë e saktë për formimin e Qeverisë së re të Kosovës nuk duket e sigurt. Ankesat dhe rinumërimet e votave kanë ngadalësuar procesin e certifikimit të rezultateve të 28 dhjetorit, ndërsa ligji parashikon që zgjedhja e presidentit të ri të Kosovës të kryhet deri më 4 mars. Nëse ky hap dështon, episodi mund të nisë sërish nga fillimi... me zgjedhje të reja.



Kosova dhe Hungaria rikonfirmojnë bashkëpunimin në fushën e bujqësisë

PRISHTINË, 19 JANAR - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Imri Demelezi, ka zhvilluar një takim miqësor me Sekretarin e Shtetit të Hungarisë, Imre Hubai, përmes të cilit u riafirmua gatishmëria për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve, veçanërisht në fushën e bujqësisë, industrisë ushqimore, mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të ujërave. “Sistemi

kundër breshrit, i cili në Hungari është plotësisht i digjitalizuar, ishte një nga temat e trajtuara në këtë takim, me ç’rast u shqyrtua mundësia që një sistem i tillë të implementohet edhe në Republikën e Kosovës”, tha ministri Demelezi. Po ashtu, ai ka treguar se në fokus u vendos përvoja e Hungarisë në shfrytëzimin e fondeve të Bashkimit Evropian për sistemet e ujitjes,

bashkëpunimi teknik në përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve, si dhe zgjidhjet inovative dhe digjitalizimi i sistemeve të ujitjes përmes projekteve pilot të financuara nga BE-ja. Ky takim u mbajt në kuadër të Forumit Global për Ushqim dhe Bujqësi, i cili u zhvillua në Berlin, në vazhden e dhjetëra takimeve bilaterale të realizuara gjatë tri ditëve të forumit.



ARRESTOHEN KATËR TË DYSHUAR PËR KEQPËRDORIM TË POZITËS ZYRTARE DHE MARRJE RYSHFETI



PRISHTINË, 19 JANAR - Policia e Kosovës, më saktë Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, në koordinim me Prokurorinë Themelore Prishtinë dhe me urdhër të Gjykatës Themelore Prishtinë, ka zhvilluar të hënën kontroll në katër lokacione të ndryshme, duke përfshirë dy shtëpi/banesa

private, një lokal afarist dhe një zyrë. Përmes hetimeve të zhvilluara, ku janë aplikuar masat e veçanta të hetimit, janë siguruar dëshmi të mjaftueshme për të dëshmuar veprat penale si: “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe “marrja e ryshfeti në sektorin privat”.

Lidhur me rastin dyshohet se katër persona të dyshuar (nga ta tre meshkuj kosovarë dhe një femër kosovare) janë përfshirë në veprat penale të lartcekura, duke marrë ryshfet nga persona të ndryshëm të cilët janë pajisur me certifikatë për leje të armës pa praninë tyre, siç e parashih ligji dhe procedurat e tjera

vijuese. Gjatë kontrollit janë sekuestruar përkohësisht: 7 telefona celularë, dosje dhe dokumente relevante në lidhje me rastin, ndërsa personat e dyshuar janë intervistuar në prani të avokatit mbrojtës dhe me vendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje deri në 48 orë.

QKSS DHE DREJTORIA E ARSIMIT NË PRISHTINË NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI PËR SIGURINË NË SHKOLLA

PRISHTINË, 19 JANAR - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) në Prishtinë, e përfaqësuar nga drejtori Samir Shahini. Ky memorandum vendos një kornizë të strukturuar bashkëpunimi në kuadër të

projektit “Një gjeneratë në rrezik: Adresimi i kriminalitetit të rinjve dhe sigurisë në shkolla përmes kërkimit dhe reformave të informuara”. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është ta mbështesë hulumtimin e bazuar në evidencë, ta forcojë koordinimin institucional dhe të kontribuojë në hartimin e politikave të informuara për

rritjen e sigurisë në shkolla dhe parandalimin e dhunës rinore. Palët riafirmojnë angazhimin e tyre për respektimin e standardeve profesionale dhe etike, mbrojtjen e të dhënave dhe zbatimin e qasjeve gjithëpërfshirëse, me synimin e krijimit të një mjedisi shkollor më të sigurt dhe mbështetës për nxënësit.



PECI KËRKON NGA DREJTORËT RITJE TË EFIKASITETIT, TRANSPARENCË INSTITUCIONALE DHE QASJE PËR TË GJITHË QYTETARËT



MITROVICË, 19 JANAR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Faton Peci, së bashku me nënkryetarin Enis Osmani, ka mbajtur takimin e parë me Bordin e Drejtorëve, me ç’rast i ka uruar ata për detyrën e re dhe u ka dëshiruar suksese në punën e tyre. Gjatë takimit Peci ka kërkuar nga drejtorët të fillojnë menjëherë me angazhimin e tyre, duke evidentuar gjendjen aktuale në secilën drejtori dhe duke përcaktuar tri prioritetet kryesore, me qëllim të orientimit të qartë të punës dhe arritjes së rezultateve konkrete

për qytetarët. Kryetari Peci ka theksuar nevojën për rritje të efikasitetit, transparencë institucionale dhe qasje për të gjithë qytetarët, duke e vendosur shërbimin ndaj qytetarit në qendër të qeverisjes lokale. Në kuadër të diskutimeve u theksuan disa çështje prioritare për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, përfshirë: rregullimin e komunikacionit, lirimin e trotuareve nga parkimi i parregullt, trajtimin e qenve endacakë, ndërtimin e tregut, hartimin e Strategjisë Zhvillimore për Mitrovicën, me

fokus Shalën e Bajgorës si dhe lirimin e hapësirave komunale nga uzurpimet. Po ashtu, u bisedua edhe për projektet kapitale dhe investimet konkrete që pritet të realizohen gjatë qeverisjes komunale. Kryetari Faton Peci theksoi se qeverisja komunale synon të sjellë rend, rregull, ligjshmëri dhe meritokraci, përmes institucioneve funksionale dhe profesionale, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet drejtorive për realizimin e objektivave zhvillimore të komunës.

Rama takon kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Prishtinës, temë diskutimi institucionet fetare

PRISHTINË, 19 JANAR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka takuar kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Prishtinës, Hetem Sopjani, dhe imamët e qendrës, për të dëgjuar nga afër nevojat dhe perspektivat e komunitetit. “Sot, në një frymë

respekti të ndërsjellë, u takuam me kryetarin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Prishtinës, z. Hetem Sopjani, dhe imamët e Qendrës, për të dëgjuar nga afër nevojat dhe perspektivat e komunitetit. Kryeqyteti do të vazhdojë të kultivojë dialog të

hapur, mirëkuptim dhe bashkëjetesë që na afron si popull”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Ai ka thënë se institucionet fetare janë pjesë e rëndësishme e jetës sonë shoqërore dhe kontribuojnë në ndërtimin e

solidaritetit, empatisë dhe harmonisë, vlera që e bëjnë Prishtinën një qytet të hapur dhe njerëzor për të gjithë. “Prishtina ndërtohet çdo ditë mbi respektin e ndërsjellë dhe ndjenjën e përkatësisë së përbashkët”, ka thënë Rama.



ËNDRRA AMERIKANE NË PRITJE: MIJËRA SHQIPTARË TË PREKUR NGA PEZULLIMI I VIZAVE TË EMIGRIMIT

Mijëra njerëz në Kosovë dhe Shqipëri, që kishin ëndërruar për vizat e emigrimit për në ShBA, po përballen me një pasiguri të papritur. Pezullimi i vizave për emigrim nga administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, ka ngrirë planet e tyre, duke ua zbehur shpresat për ëndrrën amerikane



PRISHTINË, 19 JANAR - E hënë, 4 prill 2022. Me valixhe në duar, çantë në krahë dhe shumë ëndrra në mendje e zemër, Artina - emër i vendosur nga redaksia e Radios Evropa e Lirë për ta ruajtur anonimitetin e së intervistuarës - u nis drejt ShBA-së.

Në maj të vitit paraprak ajo ishte përzgjedhur fituese e asaj që njihet si 'Ilotaria e Kartës së Gjellbër', por që në të vërtetë quhet Programi i Vizave të Diversitetit.

Artina ishte nxitur të aplikonte nga partneri i saj. Ky i fundit kishte 12 vjet rresht që aplikonte, pasi të ardhmen e tij s'e shihte askund tjetër përveç në ShBA.

Por, fati deshi që Artina të ishte ajo që ta fitonte mundësinë për të emigruar në ShBA. Që atëherë, zemra e saj ishte e dyzuar mes dy shtëpive: të sajën në ShBA dhe asaj pranë partnerit në Shqipëri.

Qysh në gusht të vitit 2022 ata nisën procesin për bashkim familjar. Të bashkuar i mbanin vetëm vizitat e herëpashershme të Artinës në vendlindje.

Kjo distancë iu bë edhe më e vështirë kur ajo mori vesh se ishte shtatzënë. "Çdo gjë e kam përballuar vetë. Gjatë kësaj periudhe bëja udhëtime

pafund drejt Shqipërisë, sepse duhet të ruaja edhe martesën, por edhe vajza të kalonte kohë me babanë... Me shpresën se do të bashkohemi shpejt...", thotë ajo për Radion Evropa e Lirë.

E vetme në ShBA, pa familjarë e shoqëri përreth, Artina tregon se ka punuar deri në muajin e fundit të shtatzënisë, ndërsa edhe muajt e parë të mëmësisë u detyrua t'i kalonte e vetme.

Tani, ajo më shumë ankohet për "lodhjen mendore" sesa atë fizike. "Qenka e shëmtuar ndjesia kur e fut jetën tënde në një valixhe, largohesh me ëndrra, punon, sakrifikon që ta bashkosh familjen atje ku po e ndërton jetën nga e para dhe dëgjon se, fiks kur ti arrin afër fundit të sfidës...", lë në gjysmë fjalinë Artina.

E, pikërisht kur procesi i bashkimit të tyre familjar po i afrohej fundit, ShBA-ja vendosi ta pezullonte përkohësisht lëshimin e vizave të emigrimit nga 75 vende të botës, përfshirë Kosovën dhe Shqipërinë.

Ky vendim erdhi pasi presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tha se të huajt që emigrojnë në ShBA, duhet ta mbajnë veten me punë dhe jo të bëhen barrë e shtetit.

Sipas një fotografie të publikuar nga ai, rreth 41 për qind e migrantëve nga Shqipëria marrin ndihma sociale në ShBA, ndërsa nga Kosova përqindja ishte edhe më e lartë: 46. "Nga i thati digjet edhe i njomi", thotë Artina, duke shtuar se ajo ka qenë një qytetare e përkushtuar e punëtore, që s'ka tentuar thjesht të përfitojë nga shteti amerikan. Por, tani kur të gjitha proceset e vizave të emigrimit janë pezulluar, ajo do të duhet sërish ta bëjë pa partnerin e jetës rrugën drejt ShBA-së. Këtë herë, edhe me një vajzë 2 vjeçe në krahë.

Në gjendje të ngjashme janë mijëra banorë në Kosovë e Shqipëri. Disa nga ta, të kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, kanë hezituat t'i ndajnë historitë e tyre, nga frika se kjo mund t'i dëmtojë gjasat e tyre për emigrim në ShBA.

Vitin e kaluar, rreth 3.800 shtetas të Shqipërisë fituan viza të emigrimit drejt ShBA-së, si dhe rreth 650 të tjerë nga Kosova.

Artid Hila nga Shqipëria, i cili punon si konsulent për ndjekje të procedurave të emigracionit dhe vizave të tjera, ka vite që udhëheq edhe një grup në Facebook, ku ndihmon të interesuarit për emigracion në

ShBA.

Ai thotë se është shqetësuar, por jo befasuar nga vendimi i 14 janarit i ShBA-së. "Shqetësimi kryesor që dëgjoj çdo ditë, lidhet me pasigurinë totale që ka krijuar pezullimi i përpunimit të vizave të emigracionit. Aplikantët kanë frikë se po ecin përpara me të gjithë hapat e kërkuar nga Departamenti i Shtetit, ndërkohë që ekziston rreziku real që viti fiskal të përfundojë pa u lëshuar vizat", thotë Hila për REL-in.

Ai tregon se procesi nuk është i thjeshtë: duhet plotësim i disa formularëve, ekzaminime mjekësore, përgatitje e dokumenteve dhe pagesë e tarifave. "Shumë aplikantë kanë investuar vite pritjeje [në rastet e bashkimeve familjare], qindra apo mijëra dollarë në dokumente, përkthime, kontrolle mjekësore, udhëtime për intervista dhe plane konkrete jetese", thotë Hila.

Tani, shton ai, ata po përballen me informacione gjysmake dhe shumë lajme të pasakta e të ekzagjeruara, pasi që nuk dihet se deri kur do të zgjasë pezullimi.

Situata të ngjashme, sipas Hilës, ka pasur edhe në të kaluarën, si gjatë pandemisë Covid-19. Por, të ngjashme s'do të thotë

identike. "Dallimi kryesor me situatën aktuale është se sot aplikantët lejohen t'i ndjekin të gjithë hapat proceduralë dhe t'i paguajnë tarifat, por në fund rrezikojnë të mbeten pa vizë, vetëm për shkak të mbylljes së vitit fiskal - një situatë që juridikisht është shumë problematike", shpjegon Hila.

Ai shton se në shqetësimin e aplikantëve ndikon edhe një vendim tjetër. Në dhjetor të vitit të kaluar, ShBA-ja pauzoi për kohë të pacaktuar Programin e Vizave të Diversitetit, deri kur "ta dimë se kë saktësisht po e lëmë të hyjë në vendin tonë", siç kishte thënë sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio.

Edhe nga ky program kanë fituar shumë shtetas të Kosovës e Shqipërisë ndër vite. Sipas të dhënave të Departamentit amerikan të Shtetit, në mesin e listës së fundit të përfituesve të këtij programi ishin edhe 1.598 shtetas të Shqipërisë dhe 260 shtetas të Kosovës.

Si fituese e para disa viteve, Artina kishte ndërtuar shumë ëndrra. Por, tani ka shumë pasiguri. "Po më duket sikur këta katër vjet po fshihen nga jeta sikur të mos ishin asgjë", thotë ajo, e shqetësuar se ndoshta opsioni i saj i vetëm do të mbetet heqja dorë nga ëndrra amerikane.

KOSTT merr pronësinë e ngastrës në Sojevë të Ferizajt për vendosjen e baterive 90 MWh për ruajtjen e energjisë

PRISHTINË, 19 JANAR - Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka njoftuar se KOSTT-i ka marrë pronësinë e ngastrës në Sojevë të Ferizajt ku do të vendosen bateritë 90 MWh për ruajtjen e energjisë. “Me nënshkrimin e marrëveshjes mes Ministrisë

së Ekonomisë, Komunës së Ferizajt dhe KOSTT-it, punimet për bateritë do të ecin përpara në kuadër të programit kompakt me MCC-në. Bateritë do të ruajnë energji kur ka tepriçë dhe do ta kthejnë në rrjet kur kërkesa rritet, për furnizim më të qëndrueshëm

dhe kosto më të përballueshme”, ka shkruar ajo në “Facebook”. Rizvanolli ka theksuar se partneriteti Kosovë - ShBA po kthehet në një rezultat konkret: infrastrukturë që e bën energjinë më të sigurt për qytetarët.



DAVOS DHE FORUMI EKONOMIK BOTËROR: PUSHTETI, KAPITALI DHE ARKITEKTURA EKONOMIKE E BOTËS

Shkruan: Nazmi JUSUFI

Çdo vit qyteti zviceran i Davosit shndërrohet në skenën e një prej takimeve ekonomike më me ndikim në botë: Takimi Vjetor i Forumit Ekonomik Botëror (WEF). Udhëheqës politikë, drejtues të korporatave shumëkombëshe, bankierë qendrorë, akademikë dhe përfaqësues të shoqërisë civile mbledhen aty për të diskutuar gjendjen e ekonomisë globale. Zyrtarisht, Davosi promovon bashkëpunimin dhe dialogun. Por në thelb ekonomik, ai funksionon si një njeje ku bashkohen pushteti, kapitali dhe drejtimi i politikave globale.

Për vende të vogla dhe periferike si Shqipëria, Kosova apo shtetet e tjera të Ballkanit, Davosi nuk është thjesht një forum diskutimi, por një vend ku formësohen vendime dhe trende që më pas importohen si “domosdoshmëri” politike dhe ekonomike, shpesh pa pasur realisht mundësi ndikimi në to.

Edhe pse WEF nuk ka fuqi formale vendimmarrëse, ndikimi ekonomik i Davosit është i jashtëzakonshëm. Aty takohen zotëruesit më të mëdhenj të kapitalit me vendimmarrësit politikë që përcaktojnë rregullat e lojës. Në këtë kuptim, Davosi vepron si një mekanizëm joformal koordinimi i kapitalizmit global.

Për elitat politike të Ballkanit, pjesëmarrja në Davos shpesh ka më shumë vlerë simbolike sesa reale: bëhen fotografi, nënshkruhen memorandume, por hapësira reale për të ndikuar në axhendën globale është minimale. Rajoni ynë mbetet më shumë objekt i politikave sesa subjekt i tyre.

Vlera e vërtetë e Davosit nuk



qëndron te panelet publike, por te takimet e mbyllura: biseda midis qeverive dhe korporatave për klimën e investimeve, lëndët e para, rrugët tregtare, regjimet e sanksioneve, politikën energjetike dhe stabilitetin monetar. Kush ka qasje në Davos, ka qasje në kabinën drejtuese të ekonomisë botërore, një kabinë ku vendet e vogla zakonisht ulen në ulësen e pasme.

Një model i përsëritur është se Davosi fokusohet kryesisht në ruajtjen e stabilitetit të sistemit, jo në reformë themelore. Pavarësisht fjalimeve për pabarazinë, klimën dhe përfshirjen sociale, thelbi i debatit mbetet zakonisht brenda kufijve të modelit ekzistues: Qarkullimi i lirë i kapitalit mbetet i shenjtë; Korporatat shumëkombëshe mbeten aktorë qendrorë; Tregjet financiare vazhdojnë të dominojnë shpërndarjen e kapitalit; Rritja mbetet treguesi kryesor i suksesit.

Për vende si Shqipëria apo Kosova, kjo përkthehet shpesh në presion për liberalizim të shpejtë, privatizime dhe varësi nga kapitali i huaj, edhe kur

institucionet vendase janë të dobëta dhe ekonomia e brishtë. Edhe tranzicioni klimatik shpesh trajtohet si treg i ri investimesh, jo si korrigjim strukturor i sistemit gjë që rrezikon ta kthejë Ballkanin në periferi të prodhimit energjetik për të tjerët, jo në përfitues real të zhvillimit.

Nga këndvështrimi ekonomik, Davosi pasqyron një realitet themelor: ekonomia globale është gjithnjë e më shumë e përqendruar në duart e një numri të vogël korporatash, fondesh investimi dhe individësh ultra të pasur. Shumë prej CEO-ve të pranishëm përfaqësojnë kompani që: Kanë më shumë fuqi ekonomike se shumë shtete; Kontrollonjë zinxhirë furnizimi, të dhëna dhe energji; Kanë qasje të drejtpërdrejtë te vendimmarrësit politikë.

Në Ballkan, kjo shfaqet përmes modeleve ekonomike të varura nga investitorë të mëdhenj të huaj, ku shteti shpesh sillet më shumë si ndërmjetës sesa si mbrojtës i interesit publik. Kjo krijon një asimetri strukturale midis sovranitetit formal dhe fuqisë reale ekonomike.

Roli i tregjeve financiare dhe flukseve të kapitalit

Davosi është gjithashtu një barometër i sistemit financiar global. Temat kryesore përfshijnë: Normat e interesit dhe borxhet rekord; Stabilitetin e bankave dhe sistemit financiar paralel; Digjitalizimin e parasë (CBDC, kriptomonedha, infrastruktura pagesash); Fragmentimin gjeopolitik të flukseve të kapitalit.

Për ekonomitë e vogla ballkanike, këto zhvillime nënkuptojnë rritje të kostonë së borxhit, më pak hapësirë fiskale dhe varësi më të madhe nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Pas këtyre debateve fshihet një pyetje qendrore: si të menaxhohet një ekonomi botërore tepër e mbështetur në borxh pa tronditje sistematike? Strategjia dominuese është menaxhim dhe shtyrje, jo ristrukturim rrënjësor.

Një ndryshim i qartë ekonomik që po merr gjithnjë

e më shumë vëmendje në Davos është kalimi nga efikasiteti i pastër drejt sigurisë strategjike: Zinxhirët e furnizimit po bëhen më rajonalë; Politika industriale po rikthehet; Shtetet po ndërhyjnë më shumë në tregje; Teknologjia dhe energjia po bëhen mjete gjeopolitike.

Për Ballkanin, kjo mund të jetë një mundësi për rindestrializim, por edhe një rrezik për t'u shndërruar në zonë tampon mes blloqeve të mëdha ekonomike.

Problemi më i madh ekonomik i Davosit nuk është teknik, por politik: legjitimiteti. Vendime që prekin miliarda njerëz diskutohen nga një elitë shumë e kufizuar; Perceptimi se sistemi mbron kryesisht veten po rritet; Pabarazia mbetet strukturalisht e lartë.

Në Ballkan, kjo krizë legjitimiteti është edhe më e thellë, sepse qytetarët shpesh e shohin politikën ekonomike si diçka që vjen nga jashtë, jo si produkt të vullnetit demokratik.

Ekonomikisht, Davosi nuk është vend i revolucionit, por i mirëmbajtjes së sistemit. Është vendi ku elita globale përpaket: Të mbajë të menaxhueshëm një sistem gjithnjë e më të paqëndrueshëm; Të menaxhojë zhvendosjet e pushtetit; Të krijojë tregje të reja brenda strukturave ekzistuese.

Për Shqipërinë, Kosovën dhe rajonin, sfida reale nuk është të bëjnë foto në Davos, por të ndërtojnë shtete funksionale dhe ekonomi që nuk varen vetëm nga vullneti i kapitalit global.

Davos-i tregon se si funksionon realisht ekonomia botërore: jo përmes parlamenteve, por përmes negociatave të vazhdueshme midis kapitalit dhe pushtetit.

Ministria e Financave: Paga minimale rritet nga 350 në 425 euro

PRISHTINË, 19 JANAR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se paga minimale është rritur nga 350 euro bruto në 425 euro bruto, duke hyrë në fuqi nga 1 janari i këtij viti. Kjo

ministri ka njoftuar se zbatimi i vendimit për rritjen e pagës minimale do të realizohet në dy faza ashtu që të jetë më e lehtë për punëdhënësit t'i përshtaten ndryshimit në mënyrë graduale. “Faza e dytë

do të fillojë më 1 korrik, kur paga minimale do të arrijë në 500 euro bruto. Kjo rritje përbën një masë të rëndësishme për rritjen e mirëqenies së punëtorëve dhe përafrimin e pagës minimale

me kushtet aktuale të tregut të punës.

Institucionet përgjegjëse do të sigurojnë zbatimin e plotë dhe të rregullt të këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi”, ka njoftuar Ministria e



Financave, Punës dhe Transfereve.

MIRË SE VINI NË BASHKIMIN E VËRTETË SOVJETIK - PRIMITIV, BRUTAL DHE RACIST

Historia e re madhështore e Mark B. Smithit, Dalja nga Stalini: Bashkimi Sovjetik si një qytetërim, 1953-1991, [Exit Stalin: The Soviet Union as a Civilization, 1953-1991] e zhvesh realitetin e jetës së përditshme gjatë spirales së vdekjes së Bashkimit Sovjetik

Nga: Simon HEFFER / The Telegraph

Për shumicën prej nesh në Perëndim, “Rusia” ishte sinonim i Bashkimit Sovjetik deri në rënien e Murit të Berlinit. Ndër 15 shtetet përbërëse të perandorisë komuniste, Rusia ishte gjithmonë ajo më e rëndësishmja. Ajo kishte kryeqytetin e BRSS-së, Moskën, dhe qytetin tjetër të madh, Leningradin (tani Shën Petersburg); ajo përbënte pjesën më të madhe të prodhimit ekonomik dhe industrial të këtij

detyrë për pak më shumë se dy vjet. Gorbachevi, vetëm 54 vjeç kur mori pushtetin, arriti ta varrosë projektin sovjetik. Duke analizuar sundimin gjashtëvjeçar të Gorbachevit, tani duket si një epokë e artë përpara se BRSS-ja të shembej dhe klouni i dehur Yeltsin të bëhej presidenti i parë i Rusisë. Ky i fundit do të hapte rrugën për rikthim në tirani nën Putinin. Kjo është historia tragjike dhe Smith e tregon në mënyrë madhështore. Megjithatë, Dalja nga Stalini nuk është thjesht një histori politike e një vendi që luftoi për dekada të

psikiatrike, për asnjë arsye tjetër përveçse kishin guximin të dilnin dhe të protestonin. Disa, si Aleksandr Solzhenicini, u dërguan në gulag. Vetëm në epokën e Brezhnev, gjërat do të përmirësoheshin: Andrey Sakharov dhe gruaja e tij, Elena Bonner, u dërguan në internim të brendshëm në një apartament provincial. Dalja nga Stalini nuk na lë kurrë në një përshtypje tjetër përveç asaj se jeta në Bashkimin Sovjetik, qoftë sipas standardeve absolute apo krahasuese, ishte e tmerrshme, ndërsa ai e paraqet Stalinin, në veçanti, si dikë i cili për krimet e sundimit të tij dhe për hijen që la për dekada pas vdekjes së tij, meriton plotësisht të barazohet me Hitlerin. Duke u përqendruar te jeta e përditshme e popullit sovjetik, yjet e tyre të muzikës pop, filmat që shikonin, qasja (ose mungesa) ndaj mallrave të konsumit dhe kushtet e tyre të zymta të jetesës, Smithi përshkruan një shoqëri jo aq në mes të një krize kolektive nervore - megjithëse aspekte të saj duket se mbizotëronin në ditët e



Paradë në Sheshin e Kuq të Moskës: Një shfaqje me koreografi të kujdesshme për të treguar fuqinë dhe unitetin sovjetik - në kontrast me realitetet e jetës prapa këtij spektakli (Foto: Express/Archive Photos/Getty Images)

e Stalinit, dhe fshirja e trashëgimisë së tij nga Khrushchevi, të paktën lejuan një relaksim të pjesshëm ndaj tmerrit për gulag, për internim apo ekzekutim të pafund të radhëve të të burgosurve politikë, dhe pranimin e disa shkallëve të modernizimit.

détente solli marrëveshjet e Helsinkit, përparim drejt kufizimit të armëve, dhe lidhjen në hapësirë të astronautëve amerikanë me kozmonautët sovjetikë. Por, reformimi i vërtetë ishte tepër i ngadaltë për të ardhur. Përtej kufijve sovjetikë, bota po ndryshonte me shpejtësi dhe, brenda tyre, më shumë qytetarë sovjetikë po fillonin të ndjenin mospëlqim për atë që ata e dinin se është jo vetëm si liri, por edhe standard më i lartë jetese i ekonomive të përçmuara kapitaliste. Ndryshimi u bë i pashmangshëm, dhe ndërrimi i gjeneratave drejt Gorbachevit e përshpejtoi atë. Ai studioi Leninin dhe tekste të tjera revolucionare, por hoqi dorë nga përpjekjet për t'i lidhur ato në mënyrë mekanike me botën. Kur forcat e sigurisë, për të cilat ishte përgjegjës, zbatuan metoda tradicionale brutaliteti ndaj kundërshtarëve të shtetit, Gorbachevi dënoi ashpërsinë. Këshilltarët e tij ekonomikë i thanë atij të lëvizte drejt një ekonomie tregu. Kjo nuk ishte thjesht një çështje e popullit sovjetik që donte më shumë liri: kishte mungesa ushqimi dhe dështime teknologjike, veçanërisht në prill të vitit 1986 në centralin bërthamor të Çernobilit. Jeta u rrezikua nga ngadalësia e qeverisë për ta pranuar katastrofën, në përpunje me mënyrën tradicionale sovjetike për të fshehur të vërtetat e pakëndshme. Modeli i vjetër ishte qartësisht i thyer. Përshkrimi që i bëu Smithi rënies kaotike dhe të shpejtë të atyre viteve të fundit, është i matur dhe interesant. Pavarësisht nëse ishte qëllimi i tij apo jo, Gorbachevi del si një figurë me madhësi të vërtetë. Sa i madh është dëshpërimi që trashëgimia e tij është shpërdoruar në mënyrën siç është tani. Ky libër jashtëzakonisht i rëndësishëm paraqet një histori të idealizmit që dështoi për shkak të mungesës së brendshme të lirisë, shtypjes dhe korrupsionit të tij. Tani duket se, të paktën në Rusi, historia është në procesin e përsëritjes së vetes. /Telegrafi/



Joseph Stalin, lideri i Bashkimit Sovjetik në vitet 1924-1953(PhotoQuest/Getty Images))

unioni. Megjithatë, ajo nuk siguronte domosdo figurat udhëheqëse sovjetike. Stalini ishte gjeorgjian. Familja e Khrushchevit rridhte nga ajo që tani është Ukrainë dhe atje ai kaloi pjesën më të madhe të viteve të formimit. Pasaporta e Brezhnevit shënonte përkatësinë e tij etnike si “ukrainas”. Edhe pse Andropovi, Chernenko dhe Gorbachevi ishin të gjithë rusë, ata vinin nga pjesë aq të largëta dhe provinciale të perandorisë - Chernenko nga Siberia, dhe dy të tjerët nga Stavropoli buzë Kaukazit - sa që ata dhe figurat e tjera të Politbyrosë me prejardhje të ngjashme, klasifikohen nga historiani Mark B. Smith si “të jashtëm”. Dalja nga Stalini, libri i shkëlqyer i Smithit, është pjesërisht për mënyrën se si sovjetizmi përfundoi keqas - në mënyra të ndryshme - për shumicën prej tyre. Stalini, me vdekjen e të cilit Smithi fillon veprën, ishte bërë figurë kulti e frikës dhe urrejtjes - ndonëse kjo mbeti e fshehur deri te fjalimi “sekret” i përcaktimit të epokës nga Khrushchevit në vitin 1956. Vetë Khrushchevi u shkarkua nga kolegët e tij në vitin 1964, por të paktën iu lejua të vdiste në shtrat shtatë vjet më vonë dhe nuk u dërgua me forcë në gulag. Forma e shtypjes e Brezhnevit ishte më e butë, të paktën brenda vendit - çekët në vitin 1968 do të kishin pikëpamje më pak dashamirëse - por, ai ishte teveqel shumë kohë para vdekjes së tij në vitin 1982. Pasuesit e tij, Andropovi dhe Chernenko, morën pushtetin si pleq të sëmurë dhe së bashku qëndruan në

tëra përpara se më në fund të fitonte vendin e vet si një nga dy superfuqitë botërore. Siç thotë nëntitulli i librit, është një studim i Bashkimit Sovjetik “si qytetërim”. Smithi përqendrohet te historia kulturore dhe shoqërore, duke u siguruar që ne ta kuptojmë gjendjen e zymtë në të cilën ekzistonin njerëzit dhe klimën e frikës në të cilën, edhe pas vitit 1956 dhe çlirimit nga fantazma e Stalinit, ata duhej të jetonin. Për shembull, familjet e mëdha ishin grumbulluar në ndërtesa banimi të ndërtuara keq. Ndonjëherë atyre u duhej të paketoheshin në dy dhoma apo edhe të ndanin hapësirën me familje të tjera. Smithi shkruan për një aktore sovjetike e cila, duke u rritur në vitet 1950-1960, ndante një hapësirë dhe një banjë të vetme me 43 njerëz të tjerë. Disidentët u mbyllën në spitale




Gratë ruse mbërrinjë në Kishën e Ringjalljes në Moskë me kulaçe tradicionale të Pashkëve (1959)(Foto: Bettmann)

fundit të perandorisë sovjetike - por, në mbërthimin e një sëmundjeje mendore kolektive dhe kronike. Çdo gjë duhej të justifikohet në përpunje me revolucionin, megjithëse askush nuk ishte saktësisht i sigurt se çfarë nënkuptonte revolucionin. Vdekja



Radhët para hapjes së një dyqani ushqimor në Moskë, në nëntor të vitit 1983(Foto: Mikki Ansin/Getty Images)

Përparimi më i jashtëzakonshëm - dhe i tillë ishte efekti i tij rimoralizues mbi shoqërinë sovjetike, sa që Smith me të drejtë i jep atij theks të madh - ishte Yuri Gagarini si njeriu i parë në hapësirë në vitin 1961. Ishte një ngjarje që e vendosi këtë vend - përndryshe ende primitiv, brutal, të privuar, të egër - në vijën e parë të futurizmit. Fakti që sovjetikët nuk e çuan gjithashtu njeriun e parë në Hënë, tregon se si natyra e shoqërisë së tyre e pengoi evolucionin e shpejtë dhe efektiv të teknologjisë. Sistemi i tyre arsimor prodhoi një numër të madh e të habitshëm matematikanësh të avancuar, por kontributi që këta të fundit mund të jepnin për të ardhmen u shtyp - deri në një farë mase për arsyen sepse autoritetet shqetësoheshin për faktin se shumica nga këta matematikanë gjenialë ishin hebrenj. Brezhnevi, duke qeverisur nga 1964 deri në 1982, pati zgjuarsinë të fillonte të shqetësohej për opinionin ndërkombëtar mbi Bashkimin Sovjetik, dhe epoka e



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

LUFTA NË KOSOVË, RILINDJA ME MALLORCËN DHE ËNDRRA E BOTËRORIT: MURIQI “PUSHTON” LA LIGËN

PRISHTINË, 19 JANAR - Nëse e hapni listën e golashënuesve më të mirë të La Ligës dhe midis Kylian Mbappe, Ferran Torres dhe Robert Lewandowskit, do ta gjeni Vedat Muriqin, “Piratin” e Kosovës që ka rilindur në Spanjë, falë Mallorcës. Prizrenasi i ka shënuar 14 gola në ligë, një numër që vazhdon ta çojë atë të thyejë rekord pas rekordi, siç është ai që e shënoi në fitoren e fundit 3-2 kundër Athletic Bilbaos, ku ka shënuar një hat-trick, duke u bërë golashënuesi i dytë më i mirë në historinë e klubit Mallorca me 48 gola, duke e tejkaluar Juan Arango dhe duke iu afruar në gjashtë gola legjendarit Samuel Eto'o (54). Në Itali ai shpesh etiketohej si i ngadaltë ose i rëndë, megjithatë Muriqi është një lojtar krejtësisht i ndryshëm në La Liga, i pamëshirshëm në zonën e penaltisë dhe gjithnjë e më vendimtar, shkruan “Gianluca Di Marzio”. Lidhja e tij me Lazio nuk ka lulëzuar kurrë plotësisht: ata kishin nevojë për një sulmues tjetër pas Ciro Immobile dhe

afati kalimtar ia ka dhuruar Simone Inzaghi sulmuesin e Kosovës, i cili ka kushtuar mbi 20 milionë euro, nënshkrimi i dytë më i shtrenjtë nën drejtimin e presidentit Claudio Lotito.

Rezultatet

Disa paraqitje nga viti 2020 deri në vitin 2022 me vetëm dy gola, të dyja kundër Atalantës, në Serinë A ashtu edhe në Kupën e Italisë. Megjithatë, përvoja e tij me Lazio ka përfunduar shumë përpara afatit kur Mallorca ka vendosur ta merrte atë për 13 milionë euro në janar 2022. Një rini e dytë për sulmuesin, i cili në Spanjë ka rizbuluar qëndrueshmërinë, golat dhe entuziazmin e një fëmije që është rritur me një top në këmbë pavarësisht frikës nga lufta në Kosovë.

Nga lufta në La Liga me Mallorcën

Vetë lufta ishte përvoja më e vështirë për Muriqin. Vetëm

gjashtë vjeç, ai ishte detyruar ta braktiste qytetin e tij të lindjes, Prizrenin. “Ata morën sende me vlerë dhe para. Na thanë se do ta bombardonin shtëpinë tonë nëse nuk do të ikim brenda dy orësh. Ne ishim të mbrojtur nga Allahu. Ishim 50 veta, flinim në bodrum dhe kishim dy litra qumësht për t'i ushqyer njerëzit. Hëngrëm bukë dhe qepë për mëngjes, drekë dhe darkë”, kishte thënë Muriqi në një intervistë të vjetër me “Gazzetta dello Sport”. Konfliktet midis Serbisë dhe Kosovës do ta formësonin adoleshencën e tij, por qëllimi i tij ishte gjithmonë një: të bëhej futbollist. Muriqi e ka arritur këtë në vitin 2005 me KF Liria, në atdheun e tij, përpara se të transferohej në Turqi.

Ëndrra e Kupës së Botës me Kosovën

Ka kaluar ca kohë që kur një lojtar i Mallorcës ka shënuar një hat-trick që nga viti 2008, i fundit ishte Dani Güiza kundër Real Murcia. Vedat Muriqi e ka thyer këtë mit



kundër Athletic Bilbaos, madje duke iu përkushtuar babait të tij: “Nëse do të ishte gjallë sot, do ta kishte festuar ditëlindjen. Djali im mban emrin e tij. Ai vdiq kur unë isha 7 vjeç”. Synimet e Muriqit, përveç qëndrimit tek Mallorca, përfshijnë ëndrrën e Kupës së Botës me Kosovën. Ekipi kombëtar i drejtuar nga Franco

Foda do të përballlet me Sllovakinë në mars, përpara se të luajë potencialisht në finale kundër Turqisë ose Rumanisë. Muriqi është padyshim simboli i Kosovës, si dhe golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve me 32 gola. Qoftë Mallorca apo Kosova, Vedat Muriqi nuk dëshiron të ndalojë së ëndërruari.

XHAKA RRËFEN PSE ZGJODHI SUNDERLANDIN

SUNDERLAND, 19 JANAR - Granit Xhaka ka treguar se si disa ish-lojtarë të Sunderlandit e ndihmuan të merrte vendimin për t'u bashkuar me klubin anglez këtë verë. Ish-lojtari i Arsenalit është transferuar te “Macet e Zeza” për një paketë prej 17 milionë funtesh, pasi klubi është rikthyer në Premierë Ligë pas një periudhe të gjatë. Sunderlandi menjëherë e ka emëruar kapiten dhe Xhaka është duke shkëlqyer nën drejtimin e Regis Les Bris, duke i ndihmuar “Macet e Zeza” të ngjiten lart dhe të synojnë edhe Evropën, shkruan “The Sun”. 33-vjeçari ka pranuar se mendonte se do ta përfundonte karrierën e tij në Gjermani, pasi kishte nënshkruar një kontratë afatgjatë me Bayer Leverkusenin. Por, kur Sunderlandi e kishte



kontaktuar, ai ka thënë se dëshironte një sfidë të re. Pas bisedimeve me familjen, Xhaka është kështilluar nga dy ish-lojtarë të klubit Jermain Defoe, heroi i Tottenhamit që kishte një periudhë të suksesshme te Sunderlandi dhe Lorik Canën, i cili ishte bashkuar me klubin në vitin 2009. “Nuk prisja të kthehesha në Premierë Ligë, por vendimi im erdhi shumë shpejt. Fola me Kyril (Louis-Dreyfus), fola me Jermain Defoe dhe fola me Lorik Canën, i cili ka një prejardhje të ngjashme me timen dhe ka pasur një periudhë të shkëlqyer këtu në Sunderland. Kyril ishte shumë i hapur që nga fillimi. Pastaj, kur fillon ta shohë veten duke ardhur në këtë klub, pyet ish-lojtarët, dhe Jermaini dhe Loriku folën shumë mirë për klubin dhe tifozët”, ka thënë

Xhaka duke folur për “FourFourTwo”. Xhaka gjithashtu ka kujtuar kontratën e tij në Gjermani. “Kur u largova nga Arsenali për në Leverkusen, nënshkrova një kontratë pesëvjeçare. Ishte afatgjatë për një 30-vjeçar, sepse mendova se doja të përfundoja në Gjermani, pastaj të shihja çfarë do të ndodhte më pas”, ka thënë Xhaka. Më tutje mesfushori Xhaka ka theksuar rëndësinë e vendimit familjar. “Por pas bisedimeve me Sunderlandin, gjeta veten ulur me familjen, duke menduar: ‘Çfarë të bëjmë?’ Nuk ka të bëjë vetëm me mua në këtë fazë – ka të bëjë me gruan, fëmijët, vëllanë dhe prindërit. Është e rëndësishme të marrim vendimin e duhur si një grup, së bashku”, ka përfunduar Xhaka.

Senegali triumfon në Kupën e Afrikës

RABAT, 19 JANAR - Futbollistët e Senegalit kanë triumfuar në Kupën e Kombeve të Afrikës pasi në finale kanë mposhtur Marokun, që ishte vend organizator i këtij edicioni. Në finalen e luajtur në Rabat të

dielën mbrëma, Senegali ka triumfuar me rezultatin 1:0 pas dy vazhdimeve nga 15 minuta. Koha e rregullt e takimit ka përfunduar 0:0, por drama e vërtetë ka ndodhur në minutat shtesë kur futbollistët e

Senegalit e lëshuan fushën për shkak të penaltisë të dhënë në favor të Marokut. Mes shumë diskutimeve e fjalosjeve, futbollistët janë kthyer në fushë, por Maroku e humbi mundësinë për të mos

e dërguar ndeshjen në vazhdime. Brahim Diaz ka dështuar nga pika e bardhë për ta dërguar ndeshjen në vazhdime, ku Senegali ka arritur të shënojë fitore.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Prishtinë, 19.01.2026

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimor-shkencor (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 47 dhe 48 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, Rregullores nr. 109/25 të datës 15.12.2025 për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve në Institutin Pedagogjik të Kosovës, Ligjit të Punës nr. 03/L212, Ligjit për Zyrarët Publik Nr. 08/L-197, vendimit nr. 110/25 të datës 18.12.2025, Këshilli Shkencor i Institutit, shpallë:

KONKURS

për ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE - AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË DHE TË HULUMTUESVE

1 (Një) hulumtues të pavarur për kurrikula në arsimin fillor

Përshkrimi i punëve:

- Studion probleme të ndryshme nga fusha e edukimit, në kuadër të fushëveprimtarisë së Institutit;
- Bën hulumtime në terren në bashkëpunim me punëtorët e tjerë shkencorë të divizionit dhe departamenteve;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushëveprimtaria e divizionit përkatës;
- Angazhohet për aftësim profesional dhe avancim në karrierë;
- Hulumton cilësinë e planeve dhe programet mësimore në arsimin fillor dhe jep rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e planeve dhe të programeve mësimore;
- Analizon (vlerëson) përshtatshmërinë e praktikave mësimore me kompetencat e Kurrikulës;
- Studion metodologjitë e mësimdhënies në raport me kërkesat e kurrikulës në arsimin fillor;
- Hulumton ngarkesën e programeve me përmbajtje në raport me moshën e nxënësve;
- Harton projekte hulumtuese për të studiuar praktikat mësimore në arsimin fillor;
- Ofron rekomandime të bazuara në dëshmi për përmirësimin e kurrikulave dhe metodologji të mësimdhënies në arsimin fillor;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë që i cakton udhëheqësi i divizionit në bashkëpunim me punëtorët shkencorë, në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese-shkencore;
- Kryen punë të tjera që i delegon udhëheqësi i departamentit dhe Drejtori.

Kandidati për hulumtues të pavarur duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të jetë i/e regjistruar në studimet e doktoratës në programe relevante me pozitën e shpallur dhe fushëveprimtarinë e Institutit Pedagogjik të Kosovës;
- Të ketë punime të publikuara në revista shkencore të indeksuara;
- Punimet e publikuara në revista shkencore të indeksuara duhet të jenë të njohura sipas rregulloreve në fuqi;
- Të ketë punime të publikuara në revistën “Kërkime Pedagogjike”;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore, brenda dhe jashtë vendit, nga fusha përkatëse;
- Të ketë marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, nga fusha përkatëse;
- Të ketë përvojë të dëshmuar për aktivitetet shkencore e profesionale nga fusha e kërkuar me konkurs.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Dëshmi për regjistrimin e studimeve të (doktoratës);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dëshmi të lëshuar nga Gjykata kompetente, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar;
- CV-në e përditësuar, së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;

- Listën e botimeve në revista ndërkombëtare të njohura sipas rregulloreve në fuqi duke evidentuar: autori/ët, titulli i punimit, revista, numri dhe/apo vëllimi i botimit si dhe linku i indeksimit me numër DOI (me kopjen e botimeve të paraqitura);
- Listën e botimeve në revista tjera, vendore e ndërkombëtare duke evidentuar: autori/ët, titulli i botimit, lloji i botimit, botuesi dhe vegëza e botimit me <https://www...> (me kopjen e botimeve të paraqitura);
- Dëshmi tjera për të arriturat shkencore si: artikuj, libra, monografi, konferenca shkencore, etj. (me kopjen e botimeve të paraqitura);
- Të gjitha dëshmitë duhet të përgatiten sipas shtojcës I dhe II e cila gjendet në Rregulloren për Zgjedhjen dhe Rizgjedhjen e punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve të Institutit;
- Me rastin e aplikimit kandidatët i bashkëngjisin kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e publikimit të tij në faqen zyrtare të Institutit në internet, Gazetën “Epoka e Re” dhe SIMBNJ.

Zgjedhja e personelit shkencor të Institutit Pedagogjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore - shkencore, Ligjit për Zyrarët Publik Nr. 08/L-197, të Statutit të Institutit Pedagogjik dhe të Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencor dhe Hulumtuesve. Pozita është me mandat 3 vjeçar me mundësi rizgjedhje, zgjedhje apo avancim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/20020169, prej orës 08:00 - 16:00.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në adresën: Instituti Pedagogjik i Kosovës në Prishtinë, (Pejton, rruga “Lorenç Antoni”, nr. 38).

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besmir Elezi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “22 Dëshmorët” në Randogrovë Prizren.
- Bekim Berisha nga Rogova, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. “Haxhi Hoti”, Rogovë, Gjakovë.
- Fatbardhe Batusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. “Jahë Salihu”, Molliq, Gjakovë.
- Nobel Ajroni B.I, nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin identifikues të biznesit me numër: 811279183, të lëshuar nga ARBK.
- Sokol (Duç) Mehmetaj nga Zabllaqi i Istogut, shpall të pavlefshme certifikatën e Dëshmorit të UÇK-së, të lëshuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës..
- Jeton Hyseni B.I. shpall të pavlefshme arkën fiskale me nr. DG06603458 me nrb. 811111856.
- Zoja Lleshaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës sh.f.m.u. “Dëshmorët Leshi” Doblibare nga kl. 1-8.
- Tsunami SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin identifikues të biznesit me nr. 81220031të lëshuar nga ARBK.
- Festim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Fadil Hisari” Prizren.
- Luan Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Fadil Hisari” Prizren.
- Enver Muqaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11Marsi” Prizren.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOV
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOŠKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Priština, 19.01 mart 2026

Na osnovu Zakonu br. 04/L-135 o Naučnoistraživačka delatnost (Službeni glasnik Republike Kosovo , br. 11/02. maj 2013), član 47 i 48 Statuta Kosovskog pedagoškog instituta u Prištini, Uredba br. 109/25 od 15.12.2025. o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača u Kosovskom pedagoškom institutu, Zakon o radu br. 03/L212, Zakon o javnim službenicima br. 08/L-197, odluka br. 110/25 od 18.12.2025. godine, Naučno veće Instituta objavljuje:

K O N K U R S
za IZBOR, REIZBOR - UNAPREĐENJE NAUČNIH RADNIKA I ISTRAŽIVAČA

1 (jedan) nezavisni istraživač za kurikulum u osnovnom obrazovanju

Opis rad:

- Proučava različite probleme u oblasti obrazovanja, u okviru delatnosti Instituta;
- Sprovodi terenska istraživanja u saradnji sa drugim naučnim radnicima divizije i departamenta;
- Priprema za objavljivanje izveštaje o završenim studijama, materijalima i publikacijama iz delokruga odgovarajućeg divizije;
- Posvećen stručnom usavršavanju i napredovanju u karijeri;
- Istražuje kvalitet nastavnih planova i programa u osnovnom obrazovanju i daje preporuke za izmenu i dopunu nastavnih planova i programa;
- Analizira (procenjuje) prikladnost nastavnih praksi sa kompetencijama kurikuluma;
- Proučava metodologije nastave u odnosu na zahteve kurikuluma u osnovnom obrazovanju;
- Istražuje sadržajnu opterećenost programa u odnosu na uzrast učenika;
- Sastavlja istraživačke projekte za proučavanje nastavnih praksi u osnovnom obrazovanju;
- Pruža preporuke zasnovane na dokazima za poboljšanje nastavnih planova i programa i metodologija nastave u osnovnom obrazovanju;
- Sprema izveštaj za realizovani rad;
- Obavlja poslove koje mu zada šef divizije u saradnji sa naučnim radnicima, u okviru zajedničkih istraživačko-naučnih projekata;
- Obavlja i druge poslove koje mu odrede rukovodilac departamenta i direktor.

Zainteresovani kandidati moraju ispunjavati sledeće uslove:

- Da je upisan na doktorske studije na programima relevantnim za objavljenu poziciju i obim aktivnosti Kosovskog pedagoškog instituta;
- Da ima radove objavljene u indeksiranim naučnim časopisima;
- Radovi objavljeni u indeksiranim naučnim časopisima moraju biti priznati prema važećim propisima;
- Da ima radove objavljene u časopisu „Pedagoška istraživanja“;
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima, kako u zemlji tako i u inostranstvu, u relevantnoj oblasti;
- Da je aktivno učestvovao na nacionalnim i međunarodnim konferencijama iz relevantne oblasti;
- Da ima dokazano iskustvo u naučnim i stručnim aktivnostima u oblasti koju zahteva konkurs.

Potrebna je dokumentacija

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Dokaz o upisu na (doktorske) studije;
- Izvod rođenja ne stariji od šest meseci;
- Dokaz izdat od strane nadležnog suda, kojim se dokazuje da kandidat nije osuđivan;
- Ažurirani (CV), uz koju moraju biti priloženi potrebni dokazi kojima se dokazuje situacija predstavljena u njoj;

- Spisak publikacija u priznatim međunarodnim časopisima prema važećim propisima, sa naznakom: autora(a), naslova rada, časopisa, broja i/ili sveske publikacije, kao i indeksne veze sa DOI brojem (uz kopiju dostavljenih publikacija);
- Spisak publikacija u drugim časopisima, lokalnim i međunarodnim, sa naznakom: autora(a), naslova publikacije, vrste publikacije, izdavača i linka k publikaciji <https://www...> (sa dostavljenim kopijama publikacija);
- Ostali dokazi o naučnim dostignućima kao što su: članci, knjige, monografije, naučne konferencije itd. (sa dostavljenim kopijama publikacija);
- Svi dokazi moraju biti pripremljeni prema Prilogu I i II sadržanom u Pravilniku o izboru i reizboru naučnih radnika i istraživača Instituta;
- Prilikom prijave, kandidati prilažu kopije dokumenata o kvalifikacijama, iskustvu i ostalu potrebnu dokumentaciju koju zahteva posao za koji se prijavljuju.

Konkurs ostaje otvoren 30 dana od dana objavljivanja na zvaničnoj veb stranici Instituta, u Novinu „Epoka e Re“ i SIMLJR-u.

Izbor naučnog osoblja Pedagoškog instituta vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 o naučnoistraživačkoj delatnosti, Zakon o javnim službenicima br. 08/L-197, Statuta Pedagoškog instituta i Pravilnika o postupku za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača. Pozicija ima mandat od 3 godine sa mogućnošću reizbora, izbora ili napredovanja.

Kandidati izabrani sa užeg spiska biće obavešteni pismeno ili telefonom u zakonskom roku od strane Instituta, i dužni su da sa sobom ponesu originalna dokumenta o kvalifikacijama i završenoj obuci radi provere pred Komisijom.
Za etaljnije informacije možete kontaktirati na br. tel: 038/20020169, od 08:00 - 16:00.

Kompletna dokumentacija se dostavlja u arhivu MONT-a. Pedagoški institut Kosova u Prištini, (Pejton, ulica „Lorenc Antoni” br. 38).



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të datës19.01.2026 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 20.01.2026 të shpall:

KONKURS

Tre (3) Punëtor Fizik- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.
Numri i referencës: 19-01-52
Përgatitja profesionale: Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme
Lartësia e pagës mujore: 496.69 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjërë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës). Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatë fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muajt).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendrike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 20.01.2026 deri me 03.02.2026, ora 16:00.
Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com
Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
OIK

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professional



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Thelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik. Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr.04/L-150, nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut, vendimit të Këshillit Drejtues të Odës të datës 13.02.2018 dhe mbështetur në Aneksin e III të Rregullores për Organizimin e Shërbimit Profesional dhe Administrativ të miratuar me datë 22.04.2025 nga Këshilli Drejtues, OIK shpallë këtë:

KONKURS

Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK) shpall konkurs për pozitën:

Mirëmbajtës / Pastrues / Kafebërës

Pozita e stafit: 1 (një)

Paga: 420 pikē

Përgatitja profesionale: Shkollës Fillore

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Asiston në kryerjen e punëve teknike brenda objektit të OIK-ut dhe gjatë ngjarjeve të organizuara nga OIK;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike, ujësjellësit dhe sistemit të ngrohjes;
- Dërgon postën në institucionet shtetërore dhe institucione të tjera;
- Është përgjegjës/e për mirëmbajtjen, pastërtinë dhe higjienën e zyrave dhe hapësirave të OIK-ut;
- Kujdeset për evidencën, mirëmbajtjen dhe shpenzimet e mjeteve të pastrimit;
- Kryen punë të tjera profesionale sipas urdhrat të eporit të drejtpërdrejtë;
- Kryen detyrat e kafetierësit;
- Kujdeset për sigurimin e artikujve të nevojshëm për bife, mirëmbajtjen e pastërtisë, rendit dhe ruajtjen e inventarit të bifësë;
- Shërben me pije të ngrohta dhe të ftohta për stafin dhe organet e OIK-ut, sipas rendit të porosive, duke respektuar përparësinë e stafit udhëheqës;
- Kryen edhe detyrat të tjera profesionale sipas urdhrat të eporit të drejtpërdrejtë dhe Kryetarit të Përgjithshëm të OIK-ut.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Shkollës Filllore
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës;
- Të jenë në moshë madhore;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;

Procedura e konkurrimet:

- Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar;
- Aplikacionet merren, plotësohen dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00 – 14:00, në zyrat e OIK-ut.

Adresa:

Rruga "Holger Pedersen", mbrapa QKUK-së,
Kompleksi banesor "Vëllezërit Asllani".



Drejtoria e Shmllm “Luciano Motroni” në Prizren

Nr. i prot: 22 Dt: 19.01.2026

Mbështetur ne nenin 11, të Udhëzimit Administrativ-Aktivitetet jashtëkurrikulare **Nr.02/2016** dhe në vendimin nr.prot:**20** te datës: **15.01.2026**, te KDSH-së Shmlm “Luciano Motroni” në Prizren, shpall:

FTESË PËR OFERTË

Për ekskursion të maturantëve të Shmlm “Luciano Motroni” ne Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore te udhetimit) qe te paraqesin ofertat e tyre ne zarf te mbyllur, per ekskursionin e maturanteve te Shmlm "Luciano Motroni" nga Prizreni per ne Republiken e Shqiperise me date **02.05.2026** deri me **06.05.2026**

Paraqitësit në tender duhet ti plotësojnë këto kritere:

- 1.Certifikatën e biznesit me informata për biznesin.
- 2.Vërtetimin për pagesën e taksave komunale për vitin 2025 ne origjinale.
- 3.Vërtetimin e Administratës tatimore që nuk ka borgje për vitin 2025 ne origjinale.
- 4.Licencën e transportit ndërkombëtar “D”
- 5.Referencat rreth organizimit të ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit: 2023,2024,2025
- 6.Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrolli Teknik.
- 7.Kopjen e sigurimit të autobusëve, patentë shoferë të vozitësve dhe licencat CPC të vozitësve.
- 8.Autobusët të jenë komfor me klimë dhe në numër të mjaftueshëm për rreth 400 vende.
- 9.Certifikatat mjekësore për vozitësit.
- 10.Kompania të sigurojë mjekun(Certifikate pune dhe diplome të mjekut)
- 11.Dëshmi për Hotelin e ofruar në Durrës (Konfirmim rezervimi) pa të drejtë ekskluzive vetëm për një Kompani, por rezervimi të jetë për shkollën e mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren dhe me datë kur është lëshuar.
- 12.Të prezantohet ambienti (Komoditeti) së paku me foto i Hotelit, nr. i tel. të pronarit dhe adresa.
- 13.Hoteli të posedoj rreth 400 shtretër.
- 14.Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se 4 nxënës.
- 15.Të prezantohet menyuja e ushqimit dhe pijeve për tri racione ditore për 5 ditë qëndrimi.
- 16.Të prezantoj Licencën e agjencionit të akreditimeve ushqimore në vendqëndrimin e nxënësve.
- 17.Gjatë vizitave nëpër monumente të sigurohet shujta dhe pagesa e hyrjes sipas itinerarit të përcaktuar nga KDSH-ja
- 18.Hoteli të posedoj sallë për argëtim për nxënës dhe të mos shërbehen dhe lejohen pijet alkoolike.
- 19.Oferta për nxënës të liruar nga pagesa.
- 20.Agjensioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit së paku 200.000 euro.

Vërejtje: Kompania turistike fituese në përfundim të ekskursionit duhet të sigurojë nënshkrimet nga: Drejtori i shkollës, Kryetari i KDSH-se, kryetares së Këshillit të nxënësve, për përmbushjen e kushteve të përcaktuara sipas kritereve të lartcekura dhe ky dokument të dorëzohet në DKA.

Ofertuesit e interesuar aplikacionin dhe itinerarin e udhëtimit mundë ti marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.

Afati i paraqitjes në Tender është 7 ditë pune, nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni sipas UA 02/2016 me datën: **28.01.2026** në ora 16:00 (DKA)
Prizren ku mundë të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i paraparë sipas UA do të verifikoj dokumentacionin dhe kushtet e ofrura nga Kompanitë, ku do të behet vlerësimi i tyre. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjensionet turistike që i kanë të kompletuar ofertat, kanë numër të mjaftueshëm autobusësh.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjshme me çmimin më të ulët të ofertës. Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L